
THE OCCURENCE OF SOME HOOF PATHOLOGIES IN DAIRY COWS IN KOSOVO PËRHAPJA E DISA PATOLOGJIVE TË THUNDRAVE NË LOPËT QUMËSHTORE NË KOSOVË

AVNI ROBAJ, KURTESH SHERIFI, DRITON SYLEJMANI, AFRIM HAMIDI, AGIM REXHEPI, FATGZIM LATIFI
Fakulteti i Bujqësisë dhe Vetërinarisë, Departamenti i Mjekësisë Vetërinare, Universiteti i Prishtinës,
Kosovë
Email: avni-robaj@hotmail.com

AKTET IV, 1: 91-95, 2011

PËRMBLEDHJE

Shkaqet dhe faktorët favorizues për lindjen dhe zhvillimin e patologjive të thundrave dhe sëmundjeve të ndryshme janë të shumta. Të dhënat janë marrë gjatë vizitave për rregullimin e thundrave në lopët qumështore në periudhën kohore 2008-2009 në fermat e lopëve në Kosovë. Studimi ynë u përqendrua në 50 ferma që kishin mbi 10 krerë/fermë. Janë grumbulluar të dhëna mbi praninë e patologjive dhe shformimeve të thundrave. Gjithsej janë vizituar 1000 krerë që janë ndarë në dy grupe sipas moshës së tyre dhe janë bërë krahasime për paraqitjen e patologjive të thundrave: grupi parë nga mosha 0-4 vjeç dhe grupi dytë mbi 4 vjeç. Nga ky hulumtim doli se 21% e lopëve nga totali i vizituar kishin probleme me thundrat, ku 57% i takonin grupit të parë, ndërsa 43% grupit të dytë. Patologjitë më të shpeshta ishin: 23.4% me pododermatit, 19.6% me dermatit interdigital, 13.4% me dermatit digital dhe 17% flegmonë ndër-digitale. Kurse, 26.4 % e rastëve tjera kishin të bënin me shformime të theksuara të cilat u konsideruan si patologji më të lehta. Nga totali i lopëve të vizituara, në 79% të rasteve u krye kurimi i thundrave por nuk kishin probleme që u konsideruan si patologji.

Fjalë kyçe: dermatiti interdigital , flegmona, pododermatiti, lopët qumështore, Kosova.

SUMMARY

Causes and factors favorable for the onset and development of hoof pathologies and various diseases in cattle are numerous. The data for hoof pathologies were taken during visits and hoofs treatments in the dairy cows in the period 2008-2009 in cattle farms in Kosova. Our study was focused on 50 farms that had over 10 cows /farm. Data are recorded for the presence of hoof pathologies and deformities. A total of 1000 dairy cows were visited, and are divided into two groups according to their age and comparisons are made for the appearance of the hoof pathologies: first group aged 0-4 years old and second group over 4 years. The results from the study have shown that 21% of the total cows visited had problems with hoofs, where 57% belonged to the first group, while 43% to the second group. Most frequent pathologies were: 23.4% with pododermatis, 19.6% with interdigital dermatitis, 13.4% with digital dermatitis and interdigital phlegmona 17%. Whereas 26.4% of other cases related to significant deformities were grouped as light pathology. From the total cows visited, in 79% of cases of hoofs were treated but had no significant problems that were grouped as hoof pathology.

Key words: interdigital dermatitis, phlegmona, pododermatitis, dairy cattle, Kosova

HYRJE

Shkaqet dhe faktorët favorizues për lindjen dhe zhvillimin e patologjive të thundrave dhe sëmundjeve të ndryshme janë të shumta. Çalimi i lopëve qumështore, përveç në mastitet dhe çrregullimet riprodhuese është një arsye më

të zakonshme për përjashtimin e lopëve nga prodhimi. Shkaqet dhe faktorët favorizues të këtyre çrregullimeve mund grupohen si vijon: kushtet e mbarështimit dhe të mjedisit, ushqimi, faktorët anatomikë, fiziologjikë, faktorë të tjerë. Në kuadër të kushteve të mbarështimit hyjnë

dysshemetë e papërshtatshme, mungesa e shtresës, lagështia e tepërt, veprimi dëmtues i urinës dhe mungesa e lëvizjeve të kafshëve.

Të ushqyerit e njëanshëm, kalimi prej një regjimi në regjimin tjetër stallor, ushqimet e prishura, të mykura, shkaktojnë jo vetëm sëmundje të aparatit tretës, por ndikojnë edhe në prishjen e thundrave. Ndër faktorët anatomikë që veprojnë në thundër janë madhësia dhe forma e vetë thundrës, qëndrimet e gishtit dhe mënyra e hedhjes së këmbëve.

Pododermatiti nuk është një diagnozë specifike, por thjesht do të thotë inflamacion i thundrave dhe patologjive të shumta që prekin thundrat. Është shumë e rëndësishme që të krijojmë një diagnozë të saktë. Historia, mosha, ecuria e sëmundjes, prania e problemeve të lëkurës në pjesë të tjera të trupit, prania e kruarjes (*pruritus*) dhe prania e sëmundjeve sistematike në harmoni, janë faktorët që duhet të merren parasysh për të dalluar këtë sëmundje dhe të krijojmë një diagnozë të saktë. Sëmundje të ndryshme të thundrave kërkojnë edhe terapi të ndryshme (6). Dermatiti digital (DD) takohet shumë shpesh te kafshët duke shkakuar çalim, dhimbje të mëdha, humbje ekonomike për shkak të uljes së prodhimit të qumështit dhe të performancës së dobët në riprodhim (7, 9). Sëmundja u përshkrua për herë të parë në Itali më 1974 si sëmundja e Mortellaros. Ndryshimet histopatologjike të lëkurës së gjedhit të prekura nga lezionet ulçerative akute me DD janë të ngjashme në shumë vende të botës (8).

Dermatiti digital i lëkurës është konsideruar si një sëmundje infektive multifaktoriale e thundrës me një komponente të fortë bakteriale. Agjentët etiologjikë bakterialë më të shpeshtë të DD-së janë spiroketat *Treponema spp*, *T. phagedaenis*, *T. vincentii*, *T. medium* dhe *T. denticola* (2, 12, 1). Diskutimi lidhur me etiologjinë e DD-së nuk është përfundimtar dhe as postulatet dhe variantet moderne molekulare të Kochut nuk janë plotësuar për të provuar etiologjinë e DD-së (8). Kafshët e reja që mbahen në ferma me kushte jo higjienike si dhe kafshët e blera dhe të infektuara janë objektë të prirura për të zhvilluar leziona akute ulçerative të DD-së që mund të shkaktojnë

çalim dhe humbje të prodhimit (10). Faktorë të tjerë rreziku janë kur kafshët mbahen të mbyllura në stalla, lagështia dhe kafshët e prekura nga DI dhe hiperplazia interdigitale (11).

Dermatiti interdigital (DI) është pezmatimi i lëkurës ndërgjeshore që ndodhet shpesh në gjedhë. Pezmatimi interdigital është një infeksion i epidermës interdigitale që shkakton një erozion të ngadalshëm të lëkurës por jo çalim, nëse plaga bëhet e komplikuar ndodh çalimi (5). Kjo është më e theksuar në kushtet e këqija higjienike, në prodhimin e qumështit intensiv. DI shkaktohet nga një infeksion bakterial i përzier por *Dichelobacter nodosus* është konsideruar të jetë komponenti më aktiv (5).

Flegmona interdigitale është një proces i rëndë patologjik që prek si kafshët qumështore ashtu dhe kafshët e majmërisë. Zakonisht preken më tepër gjymtyrët e pasme dhe me frekuencë të madhe lopët me regjim stallor. Kjo sëmundje njihet dhe me emra tjerë si dermatiti flegmonoz, ulçera e hapësirës interdigitale etj. (4).

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë nxjerrja e një pasqyre mbi praninë e disa patologjive të thundrave në lopët qumështore në Kosovë.

MATERIALI DHE METODA

Studimi ynë u përqendrua në 50 ferma në Kosovë me numër mbi 10 krerë/fermë. Janë vizituar lopë qumështore me patologji të ndryshme të thundrave si dhe janë grumbulluar të dhëna mbi praninë e patologjive dhe shformimeve të tyre. Sot në Kosovë ka një numër të konsiderueshëm të praktikave veterinarë të cilat trajtojnë probleme të ndryshme dhe kanë ekspertë për kurimin dhe trajtimin e tyre si dhe janë të pajisur me mjete adekuatë për rregullimin e tyre.

Këtu u futën të gjitha lopët qumështore pa përjashtim race apo moshe. Metoda për përcaktimin e patologjive është realizuar me anë të kontrollit klinik dhe gjatë kurimit të tyre me pajisje adekuatë. Janë marrë të dhëna për patologjitë e thundrave në lopët qumështore për disa lloje të sëmundjeve, si dhe të dhëna për përqindjen e këtyre patologjive në gjymtyrët e pasme dhe të përparme.

Gjatë vizitave në lopët qumështore janë evidentuar dhe regjistruar kafshët me patologji dhe probleme si pododermatiti, dermatiti interdigital (ID), dermatiti digital (DD), flegmona interdigitale (FID), si dhe janë grumbulluar të dhëna për frekuencën e tyre.

Rregullimi i thundrave është bërë në mënyrë profesionale. Për këtë qëllim janë përdorur pajisje përkatëse që ekonomizojnë punën e dorës (mjetet për rregullimin e thundrave). Në rastin e deformimeve të thundrave është përdorur kriteri që gjatësia e thundrës normale duhet të jetë 7.5 cm. Përcaktimi i gjatësisë së duhur ka qenë kriter kryesor për të përcaktuar thellësinë e prerjes. Thundra e brendshme është këputur në gjatësi 7.5 cm dhe në thellësi 0.5 cm në drejtim të tokës.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Nga 1000 krerë sa janë vizituar për këtë hulumtim doli se rreth 21% e kafshëve ose 210 krerë kishin probleme me thundrat, kurse në 79% e kafshëve tjera ose për 790 krerë është bërë kurimi i thundrave por nuk kishin probleme që të konsideroheshin si patologji të thundrave.

Kafshë me patologji dhe shformime	Përqindja e kafshëve të prekura	Numri i kafshëve të prekura
Kafshë me patologji të ndryshme	21%	210
Kafshë me shformime të ndryshme	79%	790

Tabela 1. Numri i kafshëve të vizituara që kishin patologji dhe shformime të thundrave

Gjatë hulumtimi kemi vërejtur se mosha e kafshëve të prekura me probleme të shumta të thundrave si pododermatit, dermatit interdigital, dermatit digital, flegmonë interdigitale është më e madhe në grupin e parë me rreth 57%, që përfshin moshën deri 4 vjeç (120 nga 210), kurse 43% e kafshëve të trajtuara me patologji të thundrave i takonin grupit me moshë mbi 4 vjeç e sipër (90 nga 210)

Grupi	Përqindja e kafshëve të prekura	Numri i kafshëve të prekura
Grupi 1 (0-4 vjeç)	57%	120
Grupi 2 (mbi 4 vjeç)	43%	90

Tabela 2. Përqindja e kafshëve sipas moshës (g1/0-4 vjeç, g2/<4 vjeç)

Frekuenca e pododermatiteve ishte 23.4% (49 krerë nga 210), me dermatit interdigital ishte 19.6% (42 krerë), me dermatit digital ishte 13.4% (28 krerë), flegmona interdigitale ishte në 17% të rastëve ose (36 krerë), kurse 26.4% e rasteve të tjera ose (55 krerë) kishin të bënin me shformime dhe me probleme të rritjeve të thundrave të cilat i futëm në kuadër të patologjive të thundrës.

Lloji i sëmundjes	Përqindja e kafshëve të prekura	Numri i kafshëve të prekura
Kafshë me pododermatit	23.4%	49
Kafshë me dermatit ID	19.6%	42
Kafshë me DD	13.4%	28
Kafshë me flegmonë ID	17.0%	36
Shformime/patologji të lehta	26.4%	55

Tabela 3. Përqindja e kafshëve të prekura nga patologji të ndryshme

Gjymtyrët	Numri i lopëve me patologji të thundrave	Numri i lopëve të prekura
Gjymtyrët e përparme	210	90 (43%)
Gjymtyrët e pasme	210	120 (57%)

Tabela 4. Përqindja e kafshëve të prekura sipas gjymtyrëve

Hulumtimi ynë ka treguar se gjymtyrët e pasme në përgjithësi janë më të prekura se ato të

përparme. Rezultati tregoi se në 57% të rasteve patologjite u paraqitën në gjymtyrët e pasme, dhe në 43% të rasteve në gjymtyrët e përparme.

Në hulumtimin tonë është gjetur se rastët me DD kanë qenë më të shpeshta në lopët me moshë nën 4 vjeç. Kjo lidhet, edhe siç rekomandon autori (10), me kafshët e reja që mbahen në ferma me kushte jo higjienike dhe kafshët e blera të infektuara që janë objekte të prirura për të zhvilluar leziona akute ulçerative të DD-së që mund të çojnë në çalim dhe humbje të prodhimit. Në fermtat e lopëve qumështore të vizituara, shpesh lopët mbahen të mbyllura në stalla e me lagështi duke mos ju ofruar mundësi të mjaftueshme lëvizjeje, që mund të jetë faktor tjetër favorizues për shfaqjen e dermatitit interdigital dhe hiperplazisë interdigitale siç raportojnë edhe autorët e tjerë (11).

Shfaqja e dermatitit digital në 13.4% të patologjive të gjetura në hulumtimin tonë, takohet shumë shpesh te kafshët duke shkaktuar çalim, dhimbje të mëdha, humbje ekonomike për shkak të uljes së prodhimit të qumështit dhe të performancës së dobët në riprodhim (7, 9), duke bërë të rëndësishëm parandalimin dhe trajtimin e kësaj patologjie.

Me anë të rregullimit të thundrave çdo gjashtë muaj në fermtat e mëdha, prodhuesit e qumështit mund të ulin mundësitë e tyre për patologjitë në thundra (3).

Gjithashtu, marrja e ushqimit adekuat nga lopët qumështore është e rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të thundrave që theksohet nga shumë autorë (3), pasi mund të ketë ndikim negativ në prodhimtarinë e qumështit.

Fermerët duhet të bashkëpunojnë me mjekë veterinerë dhe blegtorë për të hartuar një program të ushqimit të përshtatshëm si dhe për të parandaluar patologjitë e ndryshme të thundrave.

Kafshët duhet të vëzhgohen gjatë kohës që dalin në padok një deri dy herë në ditë në mënyrë që fermerët të shohin në kohë problemet e ndryshme në fazat fillestare të patologjive të thundrave, sepse mjekimi i tyre ka një kosto të lartë që duhet ta paguajë fermeri në rast të moskujdesit të duhur.

KONKLUZIONE

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se te dy derivatet e Bombesines shfaqin veti biologjike te ngjashme me ato te Bombesines natyrore dhe kane këto veti premtuese për t'u përdorur si një radiofarmaceutikat specifik, i ri, për zbulimin e tumoreve:

1. Studimet metabolike tregojnë stabilitet te ulet ne veshka dhe melci te homogenizuar per te dy derivatet ne studim
2. Studimet in vitro te degradimit te dy konjugateve te radioshenuara tregojne stabilitet te larte ne plazme njerëzore dhe qeliza.

BIBLIOGRAFIA

1. Choi B.K., Nattërmann H., Grund S., Haider W., and Göbel U.B. 1997. Spirochetes from digital dermatitis lesions in cattle are closely related to treponemes associated with human periodontitis. *Int. J. Syst. Bacteriol.* 47:175-81
2. Evans N.J., Brown J.M., Demirkan I., Murray R.D., Vink W.D., Blowey R.W., Hart C.A., Carter S.D. 2009. Three unique groups of spirochetes isolated from digital dermatitis lesions in UK cattle. *Vet Microbiol* 130:141-50
3. Flower F.C. and Weary D.M. 2006. Effect of hoof pathologies on subjective assessments of dairy cow gait. *J. Dairy*
4. http://www.google.com/search?hl=en&source=hp&q=intërdigital+flegmona&aq=f&aqi=&aql=&oq=&gs_rfai
5. <http://www.merckvetmanual.com/mvm/index.jsp?cfile=htm/bc/90529.htm>
6. <http://www.petplace.com/dogs/pododermatitis-intërdigital-dermatitis/page1.aspx>
7. Irish Veterinary Journal (2007) Vol.60.Nr.2
8. Read D.H., and R.L. Walker 1998. Papillomatous digital dermatitis (footwarts) in California dairy cattle: clinical and gross pathologic findings. *J. Diag. Invest.* 10:67-76.
9. Rodostits O.M. et al. (2007): *Vetrrinaru medicine*, Saunders Co. Ltd., London, Great Britain
10. Rodriguez-Lainz A., P. Mellendez-Retamal, D.W. Hird, D.H. Read and R.L. Walker 1999. Farm- and host-level risk factors for

papillomatous digital dermatitis in Chilean dairy cattle. *Prev. Vet. Med.* 42:87-97.

11. Somers J.G., Frankena K. and E.N. Nordhuizen-Stassen 2005. Risk factors for digital dermatitis in dairy cows kept in cubicle houses in the Netherlands. *Prev. Vet. Med.* 71(12):11-21.

12. Strub S., J.R. van der Ploeg, K. Nuss, C. Wyss, A. Luginbühl and A. Steiner 2007. Quantitation of *Gugenheimella bovis* and treponemes in bovine tissues related to digital dermatitis. *FEMS Microbiol. Lett.* 269 (1):48-53.